



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korrektivna Sluzba Kosova / Kosovo Correctional Service

Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 06/06/2024

Duke u bazuar në nenin 12 paragraf 1, nën paragraf 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

V E N D I M

- I. Miratohet Udhëzuesi për Përcjelljen e të Burgosurve.
- II. Udhëzuesi për Përcjelljen e të Burgosurve do të zbatohet nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve dhe Institucionet Korrektuese.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga data 10 Qershor 2024.

Ismail Dibrani
Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve;
2. Institucioneve Korrektuese;
3. Arkivit të SHKK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

UDHËZUES PËR PËRCJELLJËN E TË BURGOSURVE

Qershor, 2024

Duke u bazuar neni 12, paragraf 1, nën paragraf 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

Udhëzues për Përcjelljen e të Burgosurve

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është rregullimi i hollësishëm i procedurave dhe dhënia e instruksioneve të nevojshme për stafin e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve jashtë Institucioneve Korrektuese.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky udhëzues do të zbatohet nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve dhe Institucionet Korrektuese.

Neni 3 Përkufizimet

1. Kuptimi i termave të përdorur në këtë udhëzues është si në vijim:

- 1.1. SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- 1.2. NJPB - Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve;
- 1.3. IK - Institucionet Korrektuese;
- 1.4. QO - Qendra Operative e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 4 Procedura e pranimi të detyrave për përcjellje

1. NJPB pas pranimi të urdhëresës apo kërkesës nga gjykata, prokuroria apo IK, organizon përcjelljen e të burgosurve jashtë IK.
2. Me qëllim të organizimit për përcjelljen e të burgosurve është e nevojshme që gjykatat, prokuroritë apo institucionet korrektuese të bëjnë njoftim paraprak me shkrim prej 48 orësh para realizimit të përcjelljes, përjashtimisht për rastet e veçanta kërkesa për përcjellje mund të bëhet pa njoftim paraprak.
3. Në rastet kur planifikohet të bëhet përcjellja e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë si dhe rastet tjera kur vlerësohet e nevojshme ngritja e nivelit të sigurisë Udhëheqësi i NJPB-së kërkon mbështetje nga Policia e Kosovës për përcjelljen e të burgosurve jashtë IK.

4. Nëse Policia e Kosovës nuk ka mundësi për mbështetjen e përcjelljeve për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë, NJPB organizon përcjelljen me kapacitetet e veta të brendshme sipas vlerësimit individual të rrezikshmërisë.

5. Kërkesat e parashtruara nga Institucioni Korrektues për përcjelljen e të burgosurve duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- 5.1. emri, emri i prindit dhe mbiemri;
- 5.2. data e lindjes;
- 5.3. numri i të burgosurit;
- 5.4. vepra;
- 5.5. statusi (i dënuar/paraburgosur);
- 5.6. vlerësimi i rrezikshmërisë.

6. Në rast të transferimit të burgosurit nga një institucion korrektues në një institucion tjetër korrektues, institucioni duhet të siguroj se dosja e të burgosurit është e kompletuar;

7. Në raste të jashtëzakonshme institucioni korrektues kontakton Udhëheqësin e NJPB-së, i cili autorizon zyrtarin përgjegjës të ekipit operativ në institucionin përkatës përmes telefonit për të kryer një përcjellje, i cili me të marr thirrjen organizon përcjelljen duke përgatit stafin dhe masat e nevojshme të sigurisë. Në këto raste dokumentacioni i nevojshëm duhet të kompletohet sa më shpejt që është e mundur, ndërsa dokumentacioni i rregullt do të kompletohet pas përfundimit të rastit.

8. NJPB lidhur me realizimin e detyrave përdor formularët zyrtar të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të NJPB-së

1. NJPB pas pranimi të urdhëresës për përcjellje të burgosurve jashtë IK e bënë planifikimin e përcjelljes duke caktuar zyrtarët për realizimin e detyrës dhe të njëjtën e dërgon te mbikëqyrësi i njësisë për përcjellje në IK.

2. Mbikëqyrësi i njësisë pas pranimi të detyrës nga NJPB përkujdeset për zbatimin dhe realizimin e urdhëresës për përcjelljen e të burgosurve jashtë IK duke u siguruar se:

- 2.1. numri i zyrtarëve për përcjellje është i mjaftueshëm;
- 2.2. automjetet me të cilat planifikohet të bëhet përcjellja janë në gjendje të rregullt;
- 2.3. dokumentacioni i nevojshëm.

3. Nëse mbikëqyrësi i njësisë vlerëson se numri i zyrtarëve të caktuar nga NJPB është i pa mjaftueshëm apo automjetet me të cilat është planifikuar të bëhet përcjellja nuk janë të gjendje të rregullt për përcjellje duhet ta njoftoj udhëheqësin e NJPB-së.

4. Zyrtari përgjegjës i ekipit pas marrjes së detyrës kujdeset për realizimin e përcjelljes dhe sigurohet se:

- 4.1. posedon dhjetë (10) kopje të dosjes së arratisjes;
- 4.2. posedon të gjitha dokumentet që nevojiten për përcjellje duke përfshirë urdhrin e gjykatës, prokurorisë apo kërkesat tjera për përcjelljen e të burgosurve jashtë IK;
- 4.3. automjeti i përcjelljes kontrollohet çdo herë para fillimit të përcjelljes dhe pas kthimit në IK nga vozitësi;
- 4.4. i burgosuri është kontrolluar para se të nisët nga burgu dhe pas kthimit të tij në IK nga zyrtari i përcjelljes;
- 4.5. stafi i përcjelljes është në kontakt të drejtpërdrejtë vështirimi dhe dëgjimi me të burgosurin;
- 4.6. janë të kontrollojë të gjitha mjetet shtrënguese para se ta lejoj të burgosurin të dalë nga automjeti për në destinacioni;
- 4.7. se që çdo vend i cili përdoret për mbajtjen e të burgosurit të kontrollohet në hollësi para se i burgosuri të vendoset aty, si dhe të ketë mbikëqyrje të përhershme nga zyrtarët nën përcjellje.
- 4.8. në rastet kur paraqitet vështirësi në realizimin e planit për përcjelljen e të burgosurve, zyrtari përgjegjës i ekipit ndërmerre veprimet e nevojshme për tejkalimin e situatës për të cilat veprime e njofton mbikëqyrësin e njësisë menjëherë apo sa më parë që është e mundur.
- 4.9. se të gjithë anëtarët e ekipit janë të informuar rreth detajeve relevante të detyrës së përcjelljes.

5. Zyrtari përgjegjës i ekipit ka autoritetin ta ndërpresë përcjelljen dhe të veproj sipas Planeve Eventuale si dhe ta kthejë të burgosurin në institucionin korrektues apo stacionin policor më të afërt. Në këtë rast duhet të raportoj me shkrim te Mbikëqyrësi i NJPB i cili duhet të përpiloj raport dhe ta dërgoj te udhëheqësi i NJPB dhe të përshkruhen në hollësi të gjitha rrethanat që shkaktuan ndërprerjen e përcjelljes.

6. Kur i burgosuri dërgohet në destinacioni, para se të lejohet të dalë nga automjeti, vetëm njëri zyrtarë duhet ta lërë automjetin ndërsa tjetri duhet të qëndroj brenda. Zyrtari do ta inspektojë vendin që e rrethon automjetin para se i burgosuri dhe zyrtari (zyrtarët) të dalin nga automjeti

Neni 6

Detyrat e zyrtarit përcjellës të NJPB

1. I burgosuri çdo herë duhet të jetë nën mbikëqyrje përdorësa është në përcjelljen e zyrtarit të NJPB-së.
2. Nëse i burgosuri transferohet nga një institucion korrektues në tjetrin pranim dorëzimi i të burgosurit bëhet duke e nënshkruar formularin përkatës.
3. Në rastet kur kërkohet nga autoritetet që intervestmi i të burgosurve të bëhet pa prezencën e zyrtarëve të NJPB duhet të plotësohet formulari përkatës për pranim/dorëzim.
4. Të gjithë formularët për përcjelljen e të burgosurve duhet të kthehen pas çdo përfundimi të detyrës te Koordinatori i NJPB-së për ti arkivuar.

5. Në rastet kur zyrtarët bëjnë përcjelljen e më shumë se një (1) të burgosuri në të njëjtën kohë në gjykatë ose vend tjetër së paku një (1) zyrtarë do të mbetet me të burgosurit në automjetin transportues derisa zyrtarët i përcjellin të burgosurit tjerë. Stafi i NJPB-së i cili ndodhet në gjykatë duhet të ndihmojë zyrtarin kur është e nevojshme.

6. Të burgosurit duhet të zbresin një nga një nga vetura transportuese deri në destinacion dhe anasjelltas.

7. Përderisa disa vende ku të burgosurit zbresin dhe hyjnë konsiderohen vende publike dhe jo të sigurta, zyrtari duhet të ndërpresë përkohësisht qarkullimin e kalimtarëve ose trafikut të automjeteve për të ofruar siguri (nëse është e nevojshme duhet ta njoftojë Policinë e Kosovës). Vendi duhet të pengohet vetëm deri sa është e nevojshme për kryerjen e detyrës.

8. Zyrtari duhet të sigurohet që i burgosuri të mos ketë kontakte fizike me persona tjerë.

9. Nëse është urdhëruar nga gjykata ndonjë vizitë apo kontakt me avokat apo familjar, zyrtari i NJPB-së duhet të jetë prezent gjatë vizitës (pas çdo vizite apo kontakti i burgosuri duhet të bastiset).

10. Nëse gjykata e liron të burgosurin ai kthehet në Institucionin Korrektues për ti përfunduar procedurat e lirimt.

11. Zyrtari Korrektues është i obliguar ta respektoj kodin e etikës duke u kujdesur për pamjen dhe dukjen e tij.

Neni 7

Rregullat e përcjelljes dhe kontrollimi i të burgosurve

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të ulët, përpjesëtimi minimal ndërmjet zyrtarëve të NJPB dhe të burgosurve është si në tabelën më poshtë:

Numri i të burgosurve	Numri i ZK	Mjetet shtrënguese	Numri i Automjeteve
1 - 6	Minimum 1	JO	1

2. Numri i zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit me rrezikshmëri të mesme është si në tabelën e mëposhtme:

Numri i të burgosurve	Numri i ZK	Mjetet shtrënguese	Numri i Automjeteve
1	Minimum 2	PO	1
2	Minimum 3	PO	1
3	Minimum 4	PO	1

2.1. në minimumin e zyrtarëve korrektues është i përfshirë edhe zyrtari korrektues (vozitës).

3. Të burgosurit e klasifikuar me Rrezikshmëri të Lartë duhet të përcjellën gjatë gjithë kohës me masa të shtuara të sigurisë nga ana e stafit të NJPB-së. Tabela e mëposhtme prezanton numrin minimal të zyrtarëve korrektues që duhet ta bëjnë përcjellën e të burgosurve me Rrezikshmëri të Lartë:

Numri i të burgosurve me Rrezikshmëri të Lartë	Numri i ZK	Mjetet shtrënguese	Numri i Automjeteve
1	Minimum 3	PO	1
2	Minimum 6	PO	2
3	Minimum 7	PO	Minimum 2

3.1. numri i zyrtarëve korrektues dhe i automjeteve mund të rritet varësisht nga vlerësimi i NJPB-së, por nuk mund të jetë më i vogël se numri i përcaktuar në tabelë;

3.2. nëse dy (2) të burgosur përcjellën me të njëjtin automjet, automjeti tjetër është mbështetës;

3.3. gjatë përcjelljes mund të aplikohen masa shtesë të sigurisë varësisht nga vlerësimi i rrezikut siç janë:

3.3.1. bartja e jelekut antiplumb;

3.3.2. armët e gjata;

3.3.3. prangimi i të burgosurve në duar dhe këmbë me pranga të sigurisë së lartë;

3.3.4. për të burgosurit me probleme shëndetësore duhet të bëhet vlerësim i veçantë për përdorimin e masave shtrënguese.

4. Të burgosurit gjatë pauzës apo pritjes për seancë vendosen në dhomat e mbajtjes të parapara për të burgosur. Stafi duhet të sigurohet që janë kontrolluar hapësirat mbajtëse dhe siguria është në nivel. Të burgosurit gjatë qëndrimit në dhomat e posaçme mund ti hiqen prangat varësisht nga vlerësimi i zyrtarit përgjegjës.

5. Në rast se gjyqtari vendos për shtyrjen e seancës për disa orë, përgjegjësi i ekipit vendos nëse i burgosuri duhet të mbahet në dhomat e posaçme në gjykatë apo që i burgosuri të dërgohet në institucionin me të afërt korrektues për qëndrim të përkohshëm pas konsultimit me Drejtorin e IK-së, menaxhimi i të burgosurit gjatë qëndrimit të përkohshëm bëhet nga NJPB.

6. Gjatë përcjelljes së të burgosurve me rrezikshmëri shumë të lartë NJPB mund të kërkojë mbështetje nga Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës.

7. Policia e Kosovës njoftohet nga NJPB për lokacionin e saktë ku do të realizohet përcjellja dhe informata të tjera relevante.

8. Të burgosurit me rrezikshmëri shumë të lartë që përcillen vetëm nga njësitet e NJPB-së duhet ti referohen kësaj table:

Numri i të burgosurve me Rrezikshmëri Shumë të Lartë	Numri i ZK	Mjetet shtrënguese	Numri i Automjeteve
--	------------	--------------------	---------------------

1	Minimum 5	PO	Minimum 1
2	Minimum 8	PO	2

9. Të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë që përcillen edhe me asistencën e Policisë së Kosovës duhet ti referohen kësaj tablele:

Numri i të burgosurve me Rrezikshmëri Shumë të Lartë	Numri i ZK bashkë me stafin mbështetës të PK-së	Mjetet shtrënguese	Numri i Automjeteve
1	Minimum 3	PO	Minimum 1
2	Minimum 6	PO	2

10. Varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë, distanca e përcjelljes, kushteve të rrugës, automjetit që posedojnë si dhe koha e përcjelljes do të merren masa shtesë të sigurisë.

11. Zyrtarët e përcjelljes veshin uniformën e SHKK-së për të gjitha përcjelljet. Në raste të veçanta zyrtarët e përcjelljes mund të veshin rrobat civile sipas vlerësimit dhe vendosjes të Udhëheqësit të NJPB-së.

Neni 8

Kontrollimet e të burgosurve (bastisja)

1. Para se të bëhet përcjellja të gjithë të burgosurit duhet të kontrollohen në tërësi sa i përket mjeteve të pa lejuara (kontrabandë) apo pajisjeve tjera të rrezikshme:

1.1. kontrollimet duhet të bëhen nga zyrtari/ja i NJPB-së i të njëjtës gjini;

1.2. në rast se ka dyshime të bazuara i burgosuri mund të kontrollohet me zhveshje pas aprovimit paraprak nga Drejtori i IK-së, kontrolli duhet të bëhet duke e respektuar privatësinë dhe dinjitetin e të burgosurit dhe duke u regjistruar në formularin e bastisjes.

Neni 9

Rregulla e përcjelljes

1. Përcjellja e të burgosurve duhet të kryhet duke zbatuar masat e sigurisë dhe duke respektuar dinjitetin e të burgosurve.

2. Përcjellja e të burgosurave (gjinia femërore) duhet të përfshijë minimum një zyrtare korrektuese.

3. Të burgosurat që lindin apo kanë fëmijë (nën moshën e përcaktuar me ligj) gjatë mbajtjes në institucionin korrektues për femra, gjatë përcjelljes jashtë institucionit korrektues duhet të sigurohet transport i përshtatshëm dhe ulëse adekuate për fëmijë si dhe një kujdes i veçantë.
4. Të gjitha procedurat për përcjellje jashtë IK që aplikohen për të burgosurit madhor gjithashtu aplikohen edhe për të burgosurit e mitur, varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë. Kjo përfshinë procedurat e njëjtë për bastisje, prangim dhe përcjellje.
5. Përcjellja dhe transporti i të burgosurve kryhet me automjete zyrtare që ofrojnë kushte të përshtatshme.
6. Përcjellja e të burgosurve bëhet bazuar në dokumentacionin përkatës.
7. Varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë, distanca e përcjelljes, kushteve të rrugës, destinacioni i përcjelljes, automjetit që posedojnë si dhe koha e përcjelljes do të merren masa shtesë të sigurisë.

Neni 10 **Pajisjet e sigurisë**

Stafi i NJPB-së është i ngarkuar me pajisjet e sigurisë të lejuara sipas ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucione të autorizuara shtetërore për siguri dhe Vendimit të Ministrit të Drejtësisë për Listimin e Mjeteve Kufizuese dhe Pajisjeve tjera të Sigurisë të lejuara për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Neni 11 **Përdorimi i mjeteve shtrënguese**

1. Zyrtarët Korrektues të NJPB-së do të përdorin mjetet e prangimit varësisht nga niveli i rrezikshmërisë së të burgosurit, me përjashtim të rasteve kur të dënuarit kanë rrezikshmëri të ulët.
2. Prangat e dhëmbëzuara me mbyllje të dyfishuar përdoren sipas mënyrës së mëposhtme:
 - 2.1. nga i burgosuri kërkohet të zgjat duart e tij para duke i mbajtur pëllëmbët e duarve përballë njëra-tjetrës;
 - 2.2. prangat e dhëmbëzuara vendosen mes dorës dhe kyçit të saj dhe vrima e çelësit duhet të jetë prapa dhe në pozicionin lartë;
 - 2.3. në raste specifike mund të bëhet edhe prangimi me duar mbrapa sipas vlerësimit të zyrtarit përgjegjës për përcjellje i cili vendos për këtë masë.
3. Prangat e sigurisë së lartë mund të përdoren ndaj të burgosurve me rrezikshmëri shumë të lartë dhe të lartë.
4. Lidhëset plastike përdoren sipas nevojës.
5. Për përcjelljen e më shumë se një (1) të burgosuri, të gjitha mjetet kufizuese shtesë duhet të caktohen nga zyrtari përgjegjës i ekipit operativ përkatës në formularin e urdhrat të punës.

6. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit gjatë përcjelljeve të jashtëzakonshme zbatohet varësisht nga niveli i rrezikshmërisë të burgosurit.

7. Të burgosurve mund tu bëhet prangimi edhe nga zyrtarët e gjinisë së kundërt.

8. E burgosura shtatzënë mund të prangoset vetëm nëse vlerësohet se paraqet rrezik gjatë përcjelljes, çdo herë duhet të kërkohet rekomandim i mjekut të institucionit korrektues (stafit mjekësor) për masat kufizuese për arsyeje të sigurisë gjatë përcjelljes.

9. Në rast të përcjelljes së një të burgosuri në gjendje të rëndë shëndetësore, çdo herë duhet të kërkohet rekomandim i mjekut të institucionit korrektues (stafit mjekësor) lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, kurse për masat kufizuese për arsyeje të sigurisë gjatë përcjelljes vendosë zyrtari përgjegjës i ekipit.

10. Çdo rrethanë apo rast emergjent që kërkon devijim nga udhëzimet e marra, raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur tek Mbikëqyrësi i ekipit operativ përkatës të NJPB-së dhe për këtë duhet të bëhet një raport me shkrim.

11. Me të arritur në sallë të gjyqimit, i burgosuri do të qëndrojë i pranguar derisa gjyqtari të vendos ndryshe. Çfarëdo që gjykatësi vendos brenda në sallë të gjyqit është obliguese të zbatohet. Mirëpo njëri nga zyrtarët korrektues duhet të jetë afër të burgosurit.

12. Kur i burgosuri duhet ta përdorë tualetin gjatë përcjelljes në ambientet e gjykatave, spitaleve apo institucioneve zyrtari përcjellës sigurohet që:

12.1. hapësirat dhe dritaret të kontrollohen para se të lejohet i burgosuri të hyjë për të minimizuar rrezikun e kontaktit të paautorizuar, mjeteve të rrezikshme dhe arratisjen;

12.2. vetëm një (1) i burgosur në të njëjtën kohë mund të lejohet të përdorë tualetin nën mbikëqyrjen e zyrtarit përcjellës të së njëjtës gjini dhe mjetet kufizuese mund të përdoren në rast se ato nuk shkaktojnë vështirësi të panevojshme për të burgosurin gjatë përdorimit të tualetit;

12.3. në rast se mjetet shtrënguese janë larguar për përdorim të tualetit, zyrtari përcjellës duhet të ketë kujdes të veçantë për tu siguruar se nuk ka rreziqe;

12.4. një oficer i gjinisë së njëjtë me të burgosurit qëndron në kontakt të vazhdueshëm vizual me të burgosurin;

12.5. gjatë shfrytëzimit të tualetit nga i burgosuri nuk lejohet që askush të hyjë në tualet, përveç stafit të autorizuar për sigurinë e tij.

Neni 12

Përcjellja e të burgosurve në institucionet shëndetësore

1. Për të gjithë të burgosurit që duhet të trajtohen jashtë Institucionit Korrektues, zyrtari përgjegjës i ekipit të NJPB-së duhet siguruar që:

1.1. të ketë udhëzim të mjekut;

1.2. termini është i caktuar nga stafi mjekësor (nëse është i aplikueshëm);

1.3. ka autorizim të Drejtorit të IK për dalje;

1.4. ka dosjen mjekësore e cila dorëzohet nga stafi mjekësor i institucionit, përmes protokollit, e mbyllur në zarf, konfidenciale, në të cilën ka qasje vetëm stafi mjekësor dhe e cila e përcjellë të burgosurin në të gjitha institucionet, dosja e arratisjes, vlerësimi i rrezikshmërisë, etj.

2. Me të arritur i burgosuri në spital, zyrtari përgjegjës për përcjellje duhet ta informojë mjekun (teknikun përgjegjës) për:

2.1. emrin e të burgosurit;

2.2. të gjitha mjetet kufizuese që nevojiten (nëse i burgosuri është i dhunshëm);

2.3. udhëzimi i mjekut;

2.4. urdhëresa e gjykatës për të paraburgosurit.

3. Zyrtari siguron që dhoma ekzaminuese është kontrolluar dhe është e sigurt para se të burgosurit t'i lejohet të futet në dhomë.

4. Zyrtari përcjelljes i NJPB-së do të qëndroj me të burgosurin gjatë tërë kohës dhe ai do të rri pranë të burgosurit (përveç në rrethana të veçanta kur mjeku kërkon dhe kushtet e sigurisë lejojnë dhe atë vetëm pas vlerësimit të stafit në detyrë).

5. I burgosuri mund të lihet vetëm (pa përcjellje të stafit korrektues) në raste të veçanta kur bëhet intervenim dhe veprim mjekësor specifik, si në sallat e operacionit, sallat e diagnostikës, etj, ku prezenca e zyrtarit korrektues rrezikon shëndetin e tij dhe të tjerëve. Paraprakisht në këto raste merren masat e sigurisë.

6. I burgosuri do të vazhdoj të mbahet i pranguar, përveç nëse ata duhet t'i largojnë prangat gjatë trajtimit por duhet kujdes i veçantë ndaj të burgosurit dhe mund të zëvendësohen sipas nevojës me lidhëse të plastikës.

7. Nëse mjeku (stafi mjekësor) kërkon që ti hiqen prangat për shkak të trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor, zyrtari korrektues i përcjelljes gjithmonë duhet të jetë në të njëjtën dhomë me të burgosurin dhe ta ketë nën kontroll, përpos në rastet sikur në paragrafin 4 të këtij neni.

8. Nëse mjeku refuzon ta trajtoj të burgosurin nën prezencën e zyrtarëve korrektues (dhe nëse zyrtari korrektues vlerëson se mos prania e tij paraqet rrezik), atëherë zyrtari korrektues duhet të informoj mjekun me rrezikshmërinë që paraqet heqja e masave të shtrëngimit, nëse prapë stafi mjekësor refuzon, atëherë menjëherë duhet ta informoj Udhëheqësin e NJPB-së dhe të marr udhëzimet nga ai për hapat e mëtutjeshëm.

9. Në rast se i burgosuri nuk është trajtuar, duhet të njoftohet Mbikëqyrësi i NJPB-së.

Neni 13

Përdorimi i automjetit

1. Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve përdorë automjete zyrtare të dedikuara për përcjellje.
2. Automjetet e SHKK-së të dedikuara për NJPB-në duhet të përdoren për përcjelljen e të burgosurve. Këto automjete mund të përdoren edhe për nevojat e Institucioneve Korrektuese me miratimin e paraprak të Udhëheqësit të NJPB-së.

Neni 14

Kontrollimet e automjeteve

1. Automjetet e NJPB-së që përdoren për përcjelljen e të burgosurve duhet të kontrollohen nga vozitësi i ngarkuar. Kontrolli bëhet para dhe pas përdorimit për gjërat si në vijim:
 - 1.1. kontrollimi i të gjitha bravave të dyerve që të jenë funksionale dhe të mbyllen ashtu siç duhet;
 - 1.2. të kontrollohen të gjitha mekanizmat e rripave të sigurisë për përdorim të duhur;
 - 1.3. kontrollimi gjeneral i automjetit për ti parandaluar mjetet e rrezikshme apo kontrabandës;
 - 1.4. kontrolli ditor teknik (frenat, dritat, gomat, karburantet, uji i xhamave, ndriçimi, ajrosja etj).
2. Të gjitha problemet e identifikuara në veturat e NJPB-së duhet të raportohen me shkrim te Udhëheqësi i NJPB-së.

Neni 15

Procedurat e përcjelljes me automjete e NJPB-së

1. Përcjelljet e të burgosurve duhet të bëhen me automjete të paraparë për përcjellje të burgosurve, përjashtimisht rasteve emergjente.
2. Gjatë përcjelljes së të burgosurve duhet se paku të jetë një zyrtarë i të njëjtës gjini me të burgosurin.
3. Femrat e burgosura nuk duhet të transportohen në të njëjtin automjet me të burgosur të gjinisë së kundërt.
4. Të miturit nuk duhet të transportohen në të njëjtin automjet ku gjenden të burgosurit madhorë;
5. Masa shtesë të sigurisë duhet të ndërmerren me rastin e përcjelljes së të burgosurve të kategorizuar me rrezikshmëri të lartë/shumë të lartë dhe duhet të evidentohen në Urdhrin e Punës.
6. Të burgosurit në armiqësi apo dëshmitarët e rastit konkret (palët kundërshtarë) të mos barten në të njëjtin automjet (hakmarrja, incident i më hershëm i tyre, urdhëresa e gjykatës, shkaqe shëndetësore, etj).
7. Para dhe pas përcjelljes së të burgosurit zyrtari përgjegjës i ekipit mund të kërkojë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt informata shtesë.

8. Gjatë kohës derisa të burgosurit përcjellën, ata duhet të mbikëqyren nga ana e zyrtarit të NJPB-së. Në asnjë rrethanë i burgosuri nuk duhet të lidhet për ndonjë pjesë të automjetit të përcjelljes duke përdorur mjetet e shtrëngimit.
9. Zyrtari përgjegjës i ekipit do të siguroj që automjeti ka ventilim funksional gjatë temperaturave të ndryshme.
10. Është përgjegjësi e vozitësit të automjetit që të siguroj që automjeti të jetë i gatshëm për transport.
11. Në rast se gjatë përcjelljes paraqitet nevoja apo kërkohet ndihma mjekësore për të burgosur atëherë të burgosurit duhet të i jepet ndihma e parë nëse është e mundur dhe më pas të dërgohet në institucionin më të afërt shëndetësor dhe të informohet mbikëqyrësi sa me shpejt që është e mundur.
12. Të gjitha karrocet e invalidëve, patericat duke përfshirë edhe mjete tjera protetike dhe barnat duhet të transportohen bashkë me të burgosurin por të mos jenë në posedim të burgosurit.
13. Automjetet e NJPB-së gjatë përcjelljes së të burgosurve nuk duhet të ndalojnë/parkohen gjatë rrugës deri në destinacionin e caktuar.
14. Në rast të ndonjë aksidenti, bllokimi të rrugës apo ndonjë pengesë tjetër, duhet që ta vendosin automjetin me të burgosur në një vend të sigurt dhe të njoftojnë Udhëheqësin e NJPB-së sa më parë që është e mundur (të veprohet në bazë të planeve eventuale).
15. Të gjitha aksidentet apo incidentet duhet menjëherë të raportohen tek Udhëheqësi i NJPB-së nga zyrtari përgjegjës i ekipit operativ dhe më pas ky i fundit njofton Qendrën Operative të SHKK-së.
16. Gjatë përcjelljes së të burgosurve zyrtarët korrektues të NJPB-së mund të përdorin forcën në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Zyrtari i NJPB-së i cili gjatë detyrës zyrtare përdorë forcën fizike, ka për obligim që menjëherë të njoftoj zyrtarin përgjegjës të ekipit operativ dhe me pas të përpiloj raportin me shkrim mbi përdorimin e forcës. Raportimi bëhet në formularin mbi përdorimin e forcës dhe i dorëzohet mbikëqyrësit të njësisë. Raporti mbi përdorimin e forcës duhet të plotësohet menjëherë pas ndodhjes së incidentit.
17. Në rast të ndonjë pengese gjatë përcjelljes së të burgosurit apo rasti të jashtëzakonshëm (sulm) duhet bërë çdo gjë që të arrihet në stacionin më të afërt policor apo IK (çdo herë duke ju referuar planeve eventuale) dhe sa më parë të informohet Udhëheqësi i NJPB-së.

Neni 16 **Vozitësi i automjeteve të NJPB-së**

1. Të gjithë Zyrtarët Korrektues të NJPB-së të autorizuar si vozitës duhet të jenë të pajisur me patentë shofer të vlefshëm, të vozisin në mënyrë të sigurt duke ju adaptuar kushteve klimatike dhe duke respektuar rregullat e trafikut.

2. Rugëtimi për të gjitha përcjelljet do të caktohet nga zyrtari përgjegjës i ekipit operativ nga pika e nisjes e deri në destinacionin e caktuar. Në rast të devijimit të rugëtimin për ndonjë arsye, duhet të njoftohet sa më parë zyrtari përgjegjës i ekipit operativ përkatëse nga zyrtari përgjegjës në detyrë. Në qoftë se shkaktohet devijim i rugës si rrjedhojë e kërcënimeve të brendshme apo të jashtme Policia e Kosovës duhet të lajmërohet menjëherë dhe pastaj edhe Qendra Operative e SHKK-së.
3. Të gjitha përcjelljet e të burgosurve me kombi të mbyllur gjatë errësirës ose shikueshmërisë së dobët duhet të kryhen me ndriçim të brendshëm në hapësirën ku janë të vendosur të burgosurit. Sistemi i brendshëm i ndriçimit duhet të përfshihet në kontrollimin ditor të veturës para fillimit të detyrës.
4. Në rast të ndonjë aksidenti është përgjegjësi e vozitësit të caktuar të qëndrojë në vendin e aksidentit dhe menjëherë të njoftojë Policinë e Kosovës, të plotësojë raportet e nevojshme dhe të njoftojë zyrtarin përgjegjës të ekipit operativ.
5. Nëse automjeti i përfshirë në aksident duhet të qëndrojë në vend ngjarje, Udhëheqësi i NJPB-së është i obliguar që ta siguroj një automjet tjetër për ta vazhduar përcjelljen sipas planit.
6. Në rast të kërcënimit të sigurisë ndaj stafit dhe të burgosurve zyrtari përgjegjës në detyrë mund të vendos të lëvizë nga vendi i ngjarjes, në stacionin policor apo IK më të afërt.
7. Nëse aksidenti rezulton të jetë pasojë e një tentim arratisje me ndihmën e palës së tretë, zyrtari përgjegjës duhet të aktivizoj dritat e emergjencës dhe alarmin e automjetit dhe në të njëjtën kohë të tentojë të marr sa më shumë informata që është e mundur, si: numrin targave, personave të përfshirë, etj. Brenda mundësive të zhvendoset në një vend të sigurt (bazuar në planet eventuale, në stacion të Policisë së Kosovës, IK). Zyrtari përgjegjës i ekipit operativ pas kompletimit të raportit të aksidentit duhet të njoftojë Udhëheqësin e NJPB-së i cili me pas duhet të sigurohet që të gjitha raportet e kompletuara të dërgohen në NJPB në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKK-së.
8. Rastet e tjera të aksidenteve dhe incidenteve duhet të referohen planeve eventualeve të NJPB-së.

Neni 17

Përdorimi i dritave dhe alarmet emergjente

1. Dritat dhe alarmet emergjente duhet të përdorën vetëm në raste emergjente ashtu siç është e paraparë me ligjin për siguri në komunikacion, të ofroj siguri për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë përgjatë përcjelljes së të burgosurve me rrezikshmëri të lartë apo shumë të lartë, kur trafiku është shumë i ngjeshur, ka aksidente në rrugë si dhe në rrethana që paraqesin rrezik.
2. Kur vozitja bëhet me këto masa, kujdesi duhet të jetë sa më i lartë që është e mundur në mënyrë që mos të shkaktohen aksidente apo të shqetësohen qytetarët.
3. Dritat dhe alarmet emergjente do të përdorën nëse vërehet ndonjë kërcënim ndaj të burgosurve ose zyrtarëve korrektues.

4. Dritat dhe alarmi emergjent nuk duhet të përdoret asnjëherë gjatë përcjelljeve të zakonshme përjashtimisht rasteve sikur u përmend më lartë në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 18

Ofrimi i ndihmës mjekësore pas përdorimit të forcës

Zyrtari i NJPB-së i cili gjatë detyrës zyrtare përdorë forcën fizike dhe me atë rast i ka shkaktuar lëndime personit ndaj të cilit është përdorë forca, ka për obligim që ti ofroj ndihmën e parë mjekësore (në përputhje me nivelin e trajnimit) në vend të ngjarjes dhe më pas të sigurohet që ndihma ti jepet në institucionin përkatës shëndetësor.

Neni 19

Përdorimi i armëve të zjarrit

Gjatë përcjelljes së të burgosurve zyrtarët korrektues të NJPB-së në rast nevojë mund të përdorin armën e zjarrit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Detyrat e përcjellësit të burgosurit

1. Zyrtari duhet të kryej një bastisje të dytë kur të burgosurit të kenë pasur një kontakt ose prekje të afërt me persona tjerë.
2. Gjësendet e të burgosurit gjatë transferimit nga një Institucion Korrektues në tjetrin, duhet të transportohen ndaras nga hapësira ku është i vendosur i burgosuri. Gjësendet me vlerë të cilat i përkasin të burgosurit i dorëzohen përgjegjësit të ekipit në detyrë me anë të formularit të pranim dorëzimit, të njëjtat gjësende me këtë formular i dorëzohen institucionit pranues.
3. Zyrtari Korrektues nuk duhet të lejoj asnjë artikull (p.sh. cigare, shkrepsa, lapsa, kimika, ushqim, pije, para ose artikuj tjerë) që i burgosuri të ketë në posedim gjatë përcjelljes. Përjashtohet rasti për ujë të pijes dhe shujtën e ushqimit që e siguron IK dhe ngarkohet stafi i NJPB-së.
4. Zyrtarët e NJPB-së janë përgjegjës për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të burgosurit dhe publikut gjatë detyrës së përcjelljes.
5. Zyrtarët Korrektues të NJPB-së zbatojnë procedurat e brendshme të IK dhe sigurojnë armët e tyre ashtu siç kërkohet. Në rast se zyrtari i NJPB-së duhet të futët në automjet në pjesën ku janë të burgosurit atëherë ai duhet të jetë vigjilent dhe duhet ta heq karikatorin nga arma zyrtare dhe ta vendos në vend të sigurt (qeskë). Zyrtarët e NJPB-së duhet të ushtrojnë kujdes dhe siguri kur të merren me të burgosur përderisa i bartin edhe armët me veti.

Neni 21

Trajnimet dhe testimi

1. NJPB do të organizojë trajnim fillestar pas inkuadrimin të zyrtarëve të rinj për familjarizimin me procedurat e përcjelljes së të burgosurve.

2. Staf i NJPB-së duhet të nënshtrohet trajnimeve tjera profesionale të nevojshme.
3. NJPB organizon testet e shkathtësive fizike për secilin zyrtar i cili inkuadrohet në NJPB. Nëse vlerësohet nga NJPB testet do të organizohen çdo tre (3) vite apo edhe me shpesh.
4. Zyrtari Korrektues që nuk i kalon testet fizike mund të nënshtrohet ri testimit pas 10 ditësh dhe nëse dështon përsëri i njëjti do të kthehet në detyrat e mëparshme në institucionin përkatës.
5. Stafit të NJPB-së që i janë paraqitur probleme me sëmundje kronike të cilat pamundësojnë kryerjen e detyrave lirohen nga përgjegjësit dhe detyrat e NJPB-së pas vlerësimit të mjekut.

Neni 22
Dispozitat shfuqizuese

Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzuesi për përcjelljen e të burgosurve shfuqizohen Rregullat e Brendshme të Punës, Njësi të Përcjelljen e të Burgosurve miratuar me datë: 30.11.2015.

Neni 23
Hyrja në Fuqi

Ky udhëzues hyn në fuqi nga data 10 Qershor 2024.

06.06.2024

Ismail Dibrani

Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës